

Ac.nr.2040/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Qerim Ademaj, kryetar i kolegjit, Fejzullah Rexhepi dhe Albert Zogaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit S.S. nga fshati ... Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson S.K. avokat ne Lipjan, sipas autorizimit, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson V.H. sipas autorizimit, punëtor i së njëjtës, për kompensim të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.33/2011 i datës 19.04.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me date 12.07.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe vërtetohet pika I (një) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega ne Lipjan, C.nr.33/2011 i datës 19.04.2013, në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit lidhur me kompensimin e dëmit jo material për dhimbjet trupore-fizike, frikën e shkaktuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dëmin material për bartjen e veturës dhe kamatën vjetore të gjykuar për këtë kategori të dëmit jo material dhe material.

II. Pranohet e bazuar ankesa e të paditurës dhe priset pika I (një) e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega ne Lipjan, C.nr.33/2011 i datës 19.04.2013, në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit lidhur me kompensimin e dëmit material për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues ne formë te rentës së kapitalizuar si dhe ne pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore të njohura paditësit, dhe lënda për këtë pjesë i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

III. Aktgjykimi i ankimuar në pikën II (dy) të dispozitivit mbetet i pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega ne Lipjan, më aktgjykimin e atakuar C.nr.2040/2013 i datës 19.04.2013, me pikën I (një) të dispozitivit ka vendosur qe pjesërisht të aprovojë si të bazuar kërkesëpadinë e precizuar të paditësit S.S. nga fshati ..., ku detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, qe paditësit t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 22.10.2010 ne rrugën Lipjan-Janjevë, në fshatin ...ë, më automjetin e tipit kamion „ Damler Benz 1422 " me targa te regjistrimit... dhe atë:

-Në emër të dëmit jo material, për dhimbjet trupore-fizike shumë prej 3.000 euro, për frikën e shkaktuar shumë prej 2.800 euro dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 5% shumë prej 2.000 euro, e më kamatë si për mjetet e deponuara në bankë mbi 1 vit, pa destinim të caktuar nga dita e marrjes së aktgjykimit , datë 19.04.2013 e gjer ne pagesën definitive.

- Në emër të dëmit material, për bartjen e veturës nga vendi i aksidentuar shumë prej 19.50 euro dhe për fitimin e humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues në formë të rentës së kapitalizuar shumë prej 785.50 euro, më kamatë si për mjetet e deponuara në bankë mbi 1 vit, pa destinim të caktuar, nga dita e ushtrimit të padisë, datë 20.01.2011 e gjer ne pagesën definitive.

E paditura është detyruar që paditësit të ja paguaj edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.343,68 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Me pikën II (dy) të dispozitivit është vendosur që të refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së precizuar të paditësit dhe atë:

-Në emër të dëmit jo material, për dhimbjet trupore-fizike shumë prej 500 euro dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 1.000 euro.

-Në emër të dëmit material, për ushqim të përforcuar shumë prej 70 euro, për ndihmën dhe për kujdesin e personit të tretë shumë prej 130 euro dhe për rehabilitim shëndetësor shumë prej 400 euro.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, duke e goditur për shkak të cenimit të rëndë të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën e të paditurës duke refuzuar kërkesëpadinë në tërësi si të pabazuar ose aktgjykimi i goditur të prishet dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje.

I autorizuari i paditësit nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur konform dispozitës ligjore të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 22.08.2009 rreth orës 10:25 në rrugën Lipjan-Janjevë, pikërisht në fshatin ...ë ka ndodhur aksident trafiku në mes të një kamioni transportues të markës „ Damler Benz 1422, ngjyrë të hirit, me targa të regjistrimit... i cili nuk kishte polisë të vlefshme sigurimi, të cilin e drejtonte I.Sh. nga fshati ... Komuna e Lipjanit dhe automjetit të markës Wolgswagen 19 E Golf, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit... të cilin e drejtonte këtu paditësi S.S. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit. Deri të aksidenti i ndodhur kishte ardhur më lëshimet dhe fajin e drejtuesit të Kamionit transportues të markës „ Damler Benz 1422 ", i cili

ditën e aksidentit gjersa drejtonte automjetin e tij nga pakujdesia duke menduar se nuk do te vjen gjer tek aksidenti, ndërmerr veprimin e kthimit në të majtë te Mulliri „ ... ” i cili gjendet ne fshatin ... Komuna e Lipjanit, pa u bindur se me një veprim të tillë nuk i pengon pjesëmarrësit tjerë në komunikacion dhe më këtë rast e godet me pjesën e përparme automjetin e markës Volkswagen 19 E Golf, të cilin e drejtonte paditësi i cili në atë moment po lëvizte me veturën e tij nga drejtimi i Lipjanit në drejtim të Janjevës, ku si pasojë e goditjes lëndime trupore merr paditësi, i cili dërgohet menjëherë ne Qendrën Emergjente në QKU-Prishtinë për të marrë tretmanin e nevojshëm mjekësor. Lëndimet e marra nga paditësi në aksidentin e ndodhur kanë rezultuar të jenë lëndime të rënda trupore, pasi paditësi kishte pësuar përdredhje të qafës, frakturë avolvive të skajit të poshtëm të unazës së dytë të qafës, ndrydhje të kokës dhe gërvishtje të gjurit të djathtë.

Gjykata e shkallës së parë ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të palëve ka nxjerrë dhe administruar provat nga shkresat e lëndës, ku pas analizimit dhe vlerësimit të tyre së njëjtës gjykatë i ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar. Mënyrën e vendosjes për pjesën aprovuese të kërkesëpadiës së paditësit, lidhur më dëmin jo material dhe material të gjykuar paditësit, gjykata e shkallës së parë e ka mbështetur ne dispozitat ligjore të nenit 178, 195 dhe 200 të LMD, duke ju falur në tërësi besimin ekspertizës mjekësore nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë, si dhe ekspertizës nga lëmi i aktuaristikës, por edhe provave tjera nga shkresa e lëndës, vendimin mbi kamatën e gjykuar e ka mbështetur në dispozitën e nenit 186 dhe 277 të LMD, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në dispozitën ligjore të nenit 452.1 dhe 453 të LPK.

Duke u nisur nga gjendja faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë sipas aktgjykimit të ankimuar , Gjykata e Apelit e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar ne mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, e cila ka mbështetje ne provat nga shkresat e lëndës, drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në pjesën aprovuese të kërkesëpadiës lidhur me kompensimin e dëmit jo material për dhimbjet trupore-fizike, frikën e shkaktuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe dëmin material për bartjen e veturës, ngase edhe sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit shumat e gjykuara paditësit për dëmin jo material të pësuar janë në përputhje të plotë me natyrën e shpërblimit, duke pasur parasysh rëndësinë e shkallës së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben, duke mos favorizuar synimet qe nuk përkojnë me natyrën dhe qëllimet për të cilat shërben ky shpërblim. Kompensimi në të holla i gjykuar paditësit për këtë kategori të dëmit do ti shërbej edhe si një lloj satisfakcioni moral për zbutjen e pasojave të cilat i ka pësuar nga aksidenti i ndodhur, veçmas kur kihet parasysh natyra e lëndimeve të pësuar nga paditësi, intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike dhe frikës së pësuar dhe përçindja e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor. Ndërsa dëmi material i gjykuar për bartjen e veturës ka mbështetje ne faturën nr. 0630 e datës 22.08.2010 e lëshuar nga N.T.SH „ NN ”, në bazë të së cilës konstatohet se paditësi për bartjen e veturës së tij pas aksidentit të ndodhur ka paguar shumën prej 19.50 euro.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nuk ka mundur ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë, lidhur me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditësit rreth kompensimit të dëmit material, në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues në formë të rentës së kapitalizuar, për shkak se kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, si pasojë e të cilave ka ardhur edhe gjer tek zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për faktin se dispozitivi i aktgjykimit në këtë pjesë është në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit dhe me provat nga shkresat e lëndës, e po ashtu nuk janë dhënë arsye bindëse rreth fakteve vendimtare lidhur me një mënyrë të tillë të vendosjes. Në dispozitiv të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë paditësit në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues në formë të rentës së kapitalizuar ja ka gjykuar shumë prej 785.50 euro, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit ju ka referuar shumë prej 7.850.50 euro, me çka mbetet e paqartë se cila është shuma e saktë të cilën gjykata e shkallës së parë ja ka gjykuar paditësit për këtë lloji dëmi, aq me shumë kur shuma e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar nuk përkon me shumë të cilën është potencuar nga eksperti financiar -aktuar A.B.. Gjykata e shkallës së parë po ashtu lidhur me këtë lloji dëmi, rezulton se vendimin e saj e ka bazuar në mendimin profesional të dhënë gjatë shqyrtimit kryesor nga ekspertët ortoped-traumatolog, me çka sipas gjykatës ankimore të njëjtit ekspert nuk është dashur apo nuk kanë pasur përgatitjen e duhur profesionale që të deklarohen për këtë kategori të dëmit material, pasi që për këtë mund të deklarohet vetëm eksperti përkatës i punës i cili ka përgatitje profesionale adekuate nga lëmia e punës. Sa i përket zvogëlimit të aktivitetit punues gjykata e shkallës së parë po ashtu rezulton se nuk ka dhënë arsye bindëse pse në rastin konkret është e nevojshme që paditësit në emër të fitimit të humbur për shkak të zvogëlimit të aktivitetit punues të gjykohej renta në formë të kapitalizuar, e jo renta mujore ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 188 paragrafi 2 të LMD, aq me shumë kur kihet parasysh fakti se në rastin konkret palë e paditur është Byroja Kosovare e Sigurimit, për të cilën është fakt notor se çdoherë disponon me mjete financiare, dhe realisht paditësit në të ardhmen vështire se do të mund të rrezikohet realizimi apo ekzekutimi i rentës mujore. Mbi këtë bazë aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë u dashtë që të priset dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, ka prishur edhe pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës të njohura paditësit, pa u lëshuar fare në ligjshmërinë e kësaj pjesë të aktgjykimit të ankimuar, për faktin se kjo lëndë kontestimore në një pjesë u dashtë që të priset dhe gjykatës së shkallës së parë të kthehet në rigjykim, me çka pranë asaj gjykate në procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendos me rastin e marrjes së vendimit përfundimtar, duke pasur suksesin e palëve në procedurë dhe kush ju ka dhënë shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK për të cilat gjykata e ankimit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi ankimor i palës së paditur se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë vërtetimin e plotë të gjendjes faktike kur ka obliguar të paditurën në kompensimin e dëmit palës paditëse,

për faktin se e njëjta gjykatë nuk ka vepruar sipas propozimit të te autorizuarit të palës së paditur për sigurimin e shkresave penale lidhur me fajësinë e shkaktarit të aksidentit dhe ekspertizën e komunikacionit të nxjerrë gjatë procedurës penale, për vërtetimin e kontributit të secilit pjesëmarrës në komunikacion në aksidentin e ndodhur, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pa themeltë dhe në kundërshtim me provat nga shkresat e lëndës, për faktin se në bazë të shkresave të lëndës qartë konstatohet se Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit kryesor të mbajtur ka siguruar dhe ka administruar si prova aktgjykimin penal të Gjykatës Komonale ne Lipjan P-nr. 217/2011 i datës 28.05.2011, në bazë të së cilit rezulton se shkaktari i aksidentit I.Sh. për aksidentin e ndodhur më datë 22.08.2010 në të cilin kishte pësuar lëndime trupore paditësi S.S. është shpallur fajtor dhe dënuar për vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 3 lidhur me paragrafi 1 të KPK. Si provë e njëjta gjykatë ka administruar edhe ekspertizën e komunikacionit të nxjerrë ne procedurën penale nën nr. GJPP.32/2011 dhe PP.nr. 6/2011, e punuar nga eksperti i komunikacionit rrugor Xh.M., në bazë të së cilës ka rezultuar se deri të aksidenti i ndodhur ka ardhur më lëshimet e vetme të shkaktarit të aksidentit I.Sh., i cili ditën e aksidentit ka qenë duke e vozitur automjetin transportues Daimler Benz 1422. Lidhur më këto dy prova të administruara nga gjykata e shkallës së parë rezulton se të njëjtat i janë siguruar dhe dorëzuar me kohë nga gjykata e shkallës së parë të paditurës, dhe lidhur me to janë deklaruar të autorizuarit e palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më datë 07.03.2013 dhe datë 19.04.2013, ku vërejtje nuk kanë fare në aktgjykimin penal P-nr.217/2011, ndërsa vërejtje pjesërisht kanë bërë në ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti Xh.M., pa u deklaruar decidivisht se në cilën pjesë të kësaj ekspertize bëjnë vërejtje, me çka mbi bazën e këtyre provave të administruara është bërë jokontestuese për gjykatën e shkallës së parë baza e kërkesëpadisë së paditësit, qëndrim ky të cilin e përkrah edhe Gjykata e Apelit.

Gjykata e Apelit më rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka pasur parasysh edhe te gjitha pretendimet ankimore të palës së paditur përmes ankesës së ushtruar, ku me aprovimin e pjesëshëm të tyre në një pjesë ka prishur aktgjykimin e ankimuar duke vendosur si ne pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa për pjesën tjetër të pretendimeve ankimore të palës së paditur të cilat nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Apelit, kjo gjykatë ka gjetur se janë te pathemelta dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe.

Pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, Gjykata e Apelit nuk e ka shqyrtuar fare me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, pasi qe kjo pjesë nuk është atakuar nga e paditura përmes ankesës së ushtruar.

Gjykata e shkallës së parë ne rigjykim për pjesën për të cilën është prishur aktgjykimi i ankimuar, udhëzohet qe fillimisht qoftë me propozim të palës paditëse por edhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare fillimisht të caktoj nxjerrjen e provës me ekspertim nga lëmia e punës, më nxjerrjen e së cilës duhet të konstatohet saktësisht se a kemi tek paditësi apo jo zvogëlim të aktivitetit punues, m ‘varësisht prej profesionit qe ushtron. Nëse eksperti nga lëmia e punës gjen se tek paditësi ka zvogëlim të aktivitetit punues, i njëjti duhet të sqarohet qartë se ky zvogëlim a është i përkohshëm apo i përhershëm dhe sa do të ndikoj tek paditësi ne kryerjen e punëve të përditshme ne profesion qe ai ushtron, dhe pastaj më vlerësimin e kësaj prove ne lidhshmëri edhe provat tjera, duke vërtetuar plotësisht dhe drejtë gjendjen faktike, me evitimin edhe të shkeljeve

të gjetura dhe të konstatuara nga gjykata ankimore si më lartë, të bie një vendim të drejtë dhe të bazuar ne ligj për këtë pjesë të kërkesëpadisë së paditësit.

Prandaj, nga të cekurat me lartë, e ne mbështetje te nenit 195.1 pika c) dhe d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit te Procedurës Kontestimore (LPK) u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2040/2013, datë 12.07.2016

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari,

Qerim Ademaj,d.v